

Shpallje për vendë të lirë pune

Këshillues Karriere

Kohëzgjatja	12 muaj, kontratë në përputhje me ligjin vendas.
Pozicion me kohë të plotë	40 orë / javë
Pagesa	Pagesa në monedhën vendase
Raporton direkt tek	Menaxher i Programit
Vendi i punës	Krujë, Shqipëri

Afati i fundit për aplikime: 16 Prill 2025

INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR MISIONIN E TDH NË SHQIPËRI

Terre des hommes (Tdh) Misioni në Shqipëri është një organizatë jofitimprurëse që operon për mbi 30 vjet në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke qenë ndër kontribuuesit kryesorë në ngritjen dhe forcimin e një sistemi kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri. Tdh Shqipëri zbaton programe në fushën e migracionit dhe antitrafikimit, mbrojtjes së fëmijëve dhe aksesit në drejtësi. Tdh Shqipëri punon në partneritet të ngushtë me aktorë kombëtarë dhe vendorë në advokimin, forcimin e sistemit dhe zbatimin e modeleve të shërbimeve, qasjeve dhe nismave që synojnë të përmirësojnë mirëqenien e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve në nevojë.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM RRETH PROJEKTIT

Terre des hommes do të zbatojë projektin “Fuqizimi i Jetëve – Përfshirja në Tregun e Punës” (EL-LMI) në bashkitë Kukës, Krujë dhe Kurbin. Ky projekt implementohet nga Tdh Shqipëri në kuadër të projektit më të gjerë “Bashkimi Evropian për Përfshirje në Tregun e Punës (EU4LMI)” të financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga UNDP Shqipëri, Zyra Suedeze e Punësimit Publik dhe ADRF në partneritet me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Nëpërmjet këtij projekti, 200 punëkërkuar të papunë të regjistruar, duke përfshirë të rinj të moshës 15-29 vjeç që nuk janë të punësuar, në arsim apo trajnim, nënat që nuk janë të punësuar dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, do të marrin mbështetje të drejtpërdrejtë për të pasur akses në mundësi pune gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura sipas nevojave të tregut të punës. 7 institucione publike do të fuqizohen për të zbatuar modelin e “Programit të Riintegrit Social” në bashkitë Kukës, Krujë dhe Kurbin.

Projekti u ofron çdo individ të grupit të synuar një plan të personalizuar integrimi dhe mentorim të dedikuar. Ai siguron shërbime mbështetëse për të hequr pengesat ndaj integritit në tregun e punës, duke përfshirë referime në shërbimet sociale për pjesëmarrësit dhe familjet e tyre, adresimin e nevojave të tjera të referimit në sistem dhe financimin e aksesit në aktivitete mësimore. Gjithashtu, projekti nxit vlerësimin e vetes dhe motivimin për të mësuar dhe zhvilluar karrierën, duke forcuar aftësitë e nevojshme për përfshirjen në tregun e punës. Ai ndihmon gjithashtu në përgatitjen dhe ndërmjetësimin për punësim. Për më tepër, projekti krijon një sistem referimi bashkëpunues me institucionet *partnere*, duke zbatuar një qasje të integruar përmes takimeve të koordinimit me aktorët kyç dhe sesioneve reflektuese për të përmirësuar sistemin.

QËLLIMI I POZICIONIT:

Si pjesë e ekipit të zbatimit të Projektit “Fuqizimi i Jetëve – Përfshirja në Tregun e Punës (EL-LMI)”, Këshilluesi i Karrierës është përgjegjës për hartimin e planit individual të riintegritit dhe punësimit, organizimin e takimeve individuale dhe në grup me përfituesit, monitorimin e progresit të përfituesve dhe përmbushjen e objektivave të planit, ofrimin e mbështetjes për punësim përgjatë gjithë kohëzgjatjes së programit. Plan individual i riintegritit dhe punësimit hartohet nga këshilluesi i karrierës në bashkëpunim me përfituesin e programit dhe Zyrën e Punës. Ky plan përfshin një analizë të nevojave për punësim të përfituesit, objektivat individuale të punësimit dhe afatin kohor për realizim.

Këshilluesi i Karrierës do të bashkëpunojë ngushtë me aktorët lokalë, partnerët dhe ekipin e projektit për të ofruar shërbime cilësore dhe nisma që synojnë përmirësimin e mundësive të punësimit për të rinjtë në bashkinë e Krujës. Ai/Ajo do të sigurojë



zbatimin e planit operacional, do të hartojë raporte narrative dhe do të mbështesë proceset e monitorimit dhe vlerësimit (M&V) për të garantuar arritjen e objektivave të projektit si edhe do të lehtësojë mekanizmat e koordinimit të krijuara për zbatimin e suksesshëm të projektit, duke punuar ngushtë me palët e përfshira, nën mbikëqyrjen e Koordinatorit të Projektit.

PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Harton planin individual të riintegritit dhe punësimit në bashkëpunim me përfituesin e programit dhe zyrat e punës, bazuar në një vlerësim gjithëpërfshirës të nevojave, aftësive dhe aspiratave të tyre.
- Organizon takime të rregullta në grup me përfituesit dy herë në javë për zhvillimin e aftësive për jetën.
- Zhvillon takime individuale çdo dy javë me secilin përfitues gjatë gjithë periudhës së programit të punësimit për të monitoruar progresin dhe për të siguruar përmblidhjen e objektivave të planit individual.
- Bashkëpunon me aktorët lokalë dhe referon përfituesit për punësim, vetëpunësim ose trajnim profesional.
- Ofron mbështetje për punësim për përfituesit gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit.
- Siguron realizimin në kohë dhe në mënyrë efektive të pikave kyçe të projektit, në përputhje me Planin e Zbatimit të Projektit.
- Bashkëpunon me anëtarët e ekipit të projektit dhe organizatat partnere për planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e aktiviteteve në terren.
- Ndhmon në aspektet financiare dhe logjistike të zbatimit të planeve individuale.
- Siguron që të gjitha aktivitetet e projektit të jenë në përputhje me rregulloret vendore, politikat e organizatës dhe standardet e donatorit.
- Forcon dhe ruan marrëdhënie të ngushta me autoritetet vendore, agjencitë qeveritare, bizneset dhe palët e tjera të përfshira në projekt.
- Siguron komunikim dhe bashkëpunim efektiv midis aktorëve të projektit, partnerëve dhe përfituesve të rinj për të lehtësuar një zbatim të suksesshëm.
- Siguron mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave të sakta dhe thelbësore, në përputhje me sistemin e aprovuar të M&V dhe specifikimet e projektit, për të mbështetur marrjen e vendimeve të informuara dhe raportimin.
- Përgatit dosjet e përfituesve në përputhje me standardet e projektit, duke përdorur format e përshtatshme dhe duke respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Përgatit raporte të rregullta mbi progresin për Zyrarin e Programit, duke evidentuar arritjet, sfidat dhe rekomandimet për përmirësim.
- Siguron që të dhënat e përfituesve të jenë të regjistruara saktë dhe që të përmblidhen të gjitha kërkesat për raportim, si ndaj donatorëve ashtu edhe në nivel të brendshëm.
- Jep kontribut në përgatitjen dhe dërgimin e artikujve promovues dhe historive të suksesit në zyrën e Komunikimit të Tdh, në përputhje me kërkesat e Tdh dhe të donatorëve.

PROFILI JUAJ

- Diplomë universitare në Shkenca Sociale, Psikologji, Edukim, Burime ose fusha të ngjashme.
- Minimumi 2 vite përvojë pune me grupe në nevojë, preferohet në projekte që lidhen me fuqizimin ekonomik të rinjve ose në nisma të ngjashme zhvillimi.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, gjuha angleze konsiderohet një aset.
- Aftësi të mira kompjuterike dhe përdorimi i softuerëve për menaxhim projektesh.
- Aftësi për të marrë iniciativë dhe për të respektuar afatet.
- Etikë pune dhe aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në ekip.

PËR TË APLIKUAR

Aplikantët e kualifikuar inkurajohen të dorëzojnë CV-në dhe një letër motivimi me email në adresën alb.hr@tdh.org duke përfshirë në titullin e e-mailit “**Aplikim për Këshillues Karriere, Krujë**”.

** Ju lutemi vini re se aplikimet e marra pas afatit nuk do të merren parasysh. Për shkak të numrit të lartë të aplikimeve, Tdh nuk është në gjendje t'u përgjigjet të gjithëve individualisht. Ju lutemi vini re se vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.*

Politika e mbrojtjes së fëmijëve:

Tdh (përfshirë anëtarët e stafit, kontraktorët, konsulentët) janë të përkushtuar të respektojnë Politikën e Menaxhimit të Rrezikut Tdh duke përfshirë politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e sigurisë dhe politikën kundër mashtrimit/korrupsionit, politikën e sinjalizimit. Për më shumë ju lutem referojuni lidhjes së mëposhtme <https://www.tdh.org/en/about-us/ethics-committments>.

Pajtueshmëria me RrPMDh (Rregullore e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave):

Privatësia juaj është e rëndësishme për ne.

Duke dërguar aplikimin tuaj, ju pranoni që të dhënat tuaja personale të përdoren në procesin e rekrutimit.

Çdo informacion personal i dhënë nga ju gjatë procesit të aplikimit do të trajtohet me konfidencialitet dhe do të përdoret vetëm për qëllimin e vlerësimit të kandidaturës suaj për punësim. Jini të sigurt se të dhënat tuaja nuk do të ndahen me palët e treta pa pëlqimin tuaj të qartë dhe do të ruhen në mënyrë të sigurt në përputhje me ligjet në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.